



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 21 prill 2015**

**Numri i lëndës: 2014-24**

**J.Q.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 21 prill 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 27 mars 2014. Ankuesi ka kërkuar që emri i tij mos të bëhet publik. Paneli ka pranuar kërkesën e tij.

## **II. FAKTET**

2. Më 7 mars 2013, Gjykata Themelore e Pejës ka dënuar ankuesin për vrasje, posedim, kontroll dhe përdorim të paautorizuar të armëve dhe e ka dënuar atë me njëzet e katër vjet e gjashtë muaj burgim. Ankuesi dhe pala e dëmtuar, siç duket familja e viktimave, janë ankuar.
3. Më 29 gusht 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë pjesërisht ka modifikuar aktgjykimin e shkallës së parë, ka ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale dhe ka vërtetuar pjesën tjetër të tij.
4. Më 20 nëntor 2013, me kërkesën e ankuesit, Gjykata Supreme e Kosovës pjesërisht ka modifikuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe ka ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës. Gjykata ka vërtetuar pjesën e mbetur të gjyimit.
5. Ankuesi ka parashtruar një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme më 28 janar 2014. Nuk është e qartë nëse kërkesa e tij është shqyrtuar.

## **III. ANKESAT**

6. Pa u thirrur në ndonjë dispozitë të veçantë të dokumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ankuesi pohon se është dënuar padrejtësisht.

## **IV. LIGJI**

7. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
8. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
9. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.

10. Paneli në shumë raste ka konstatuar se, sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies së OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, në parim nuk ka kompetencë as mbi aspektet administrative e as mbi aspektet juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Edhe nëse supozohet se gjykatësit e EULEX-it janë përfshirë në këtë lëndë në ndonjë fazë të procedurës, Paneli tashmë ka konstatuar në shumë raste se fakti që gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera *Rifat Kadribasic kundër EULEX-it*, nr. 2014-09, i datës 10 nëntor 2014, § 11, *Shaban Kadriu kundër EULEX-it*, 2013-27, 27 maj 2014, § 17). Paneli konstaton se nuk është argumentuar e lerë më treguar se EULEX-i ishte i përfshirë në shkeljet e supozuara të të drejtave të ankuesit.
11. Si pasojë, çështjet që janë ngritur nga ankuesi nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Si rrjedhojë, ato bien jashtë kompetencës së Panelit, siç saktësohet në rregullin 25 të rregullores së vet të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi bie jashtë juridiksionit të tij në bazë të nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

#### **SHBALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese